

20130821838

L I G J **PËR INSPEKSION FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen parimet, kompetenca, organizimi i inspeksionit financiar në sektorin publik (në tekstin e mëtejme: inspeksioni financiar), si dhe procedura për kryerjen e inspeksionit financiar.

2. Qëllimi i ligjit

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e interesave financiare të subjekteve nga sektori publik nga menaxhimi seriozisht i keq financiar, mashtrimet dhe korrupsioni.

3. Përfshirja e inspeksionit financiar

Neni 3

Inspeksioni financiar kryhet te shfrytëzuesit e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, fondet, komunat dhe Qyteti i Shkupit, agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat tjerë juridikë që janë në pronësi shtetërore ose në pronësi të komunave dhe Qytetit të Shkupit ose në të cilat shteti ose komunat dhe Qyteti i Shkupit janë aksionarë, si dhe tek organizatat joprofitabile dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë vetëm për pjesën e mjeteve të marra publike ose garancive (në tekstin e mëtejme: subjekte në të cilat kryhet inspeksion financiar).

4. Parime të inspeksionit financiar

Neni 4

Inspeksioni financiar në sektorin publikë, kryhet në pajtim me parimin e: ligjshmërisë, barazisë, paanshmëri dhe objektivitetit, lartësisë materiale, dëgjimit të subjekteve të mbikëqyrjes, publicitetit, proporcionalitet dhe supsidiaritet në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese dhe parimin e besueshmërisë që përbëhet nga ndalimi për dhënie të informacioneve gjatë inspeksionit financiar, vetëm në raste të parapara me ligj.

5. Definicione

Neni 5

Nocione të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien në vijim:

1. “Inspeksion financiar” është aktiviteti ex post për kontroll të rregullshmërisë së transaksioneve dhe aktivitetet tjera nga sfera e menaxhimit financiar dhe kontrolli i kryer në subjektet në të cilat kryhet inspeksioni;

2. “Mjete publike” janë të gjitha mjetet financiare dhe materiale të arkëtuara, të pranuar, të marra, të ndara dhe të shpenzuara nga subjektet në të cilat kryhet mbikëqyrje, duke përfshirë edhe të hyrat buxhetore, kërkesat, shpenzimet dhe subvencionet;

3. “Subjekte nga sektori publik” janë shfrytëzuesit e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, fondet, komunat dhe Qyteti i Shkupit, agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat tjerë juridikë që janë në pronësi shtetërore ose në të cilat shteti është aksionar;

4. "Menaxhim seriozisht i keqfinanciar" janë veprime ose lëshime të bëra nga personi udhëheqës ose personi tjetër me subjektin që do të mund ta çojnë apo e kanë çuar në humbje dhe/ose dëm.

5. "Mashttrim" është cildo qoftë veprim i qëllimshëm ose lëshim i lidhur me shfrytëzimin apo paraqitjen e deklaratave të rrejshme, të pasakta ose të paplota ose dokumenteve që kanë për rezultat përvetësim të paligjshëm ose mbajtje të padrejtë të mjeteve publike, mjeteve nga Bashkimi Evropian dhe mjeteve nga burime tjera vendore dhe të huaja; moszbulimi i informatave, me ç'rast cenohet ndonjë detyrim i posaçëm me efekt të njëjtë dhe përdorimi i padrejtë i mjeteve për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat fillimisht janë ndarë dhe

6. "Parregullsi" është mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve dhe i rregullave tjera si dhe i marrëveshjeve ndërkombëtare, që del nga puna ose lëshimet e shfrytëzuesve të mjeteve publike, e që ka ose mund të ketë ndikim të dëmshëm mbi Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, mbi mjetet nga Bashkimi Evropian dhe mbi mjetet nga burime tjera vendore dhe të huaja, qoftë të bëhet fjalë për të hyra/të ardhura, shpenzime/shkurtime, kthime, trashëgime ose detyrime.

II. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT GJATË KRYERJES SË INSPEKSIONIT FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

Neni 6

(1) Punët e inspeksionit financiar i kryen Sektori për inspeksion financiar në sektorin publik (në tekstin e mëtejme: Sektori), si njësi e brendshme organizative e veçantë në kuadër të Ministrisë së Financave.

(2) Me punën e inspeksionit financiar udhëheq kryeinspektori financiar për financa publike (në tekstin e mëtejme: kryeinspektori), i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjigjet para ministrit të Financave.

Neni 7

(1) Inspeksionin financiar e kryen inspektori për financa publike (në tekstin e mëtejme: inspektori financiar).

(2) Inspektori financiar është person me fakultet të kryer ekonomik ose juridik, me përvojë pune në sferën e financave dhe revizionit të brendshëm dhe të jashtëm, që i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunës shtetërorë.

(3) Inspektori financiar kryen inspeksion financiar në bazë të autorizimit të nënshkruar nga Kryeinspektori.

1. Kryeinspektori

Neni 8

Kryeinspektori i kryen punët në vijim:

- i kontrollon kërkesat, informatat ose fletëparaqitjet nga neni 10 i këtij ligji dhe jep autorizim për fillimin e inspeksionit financiar,
- i përcakton nevojat nga trajnimi i inspektorëve dhe i koordinon programet relevante për trajnim dhe
- bashkëpunon dhe shkëmben informata me subjekte tjera nga sektori publik dhe Zyra evropiane për luftë kundër mashttimeve (OLAF).

2. Inspektori financiar

Neni 9

Inspektori financiar i kryen punët në vijim:

- kryen inspeksion financiar gjatë menaxhimit me mjetet publike në pajtim me ligjin,
- i përcakton shkeljet e ligjeve, sidomos të atyre që janë të lidhura me mashttrim dhe korrupsion, që u shkakton dëm financiar subjekteve nga sektori publik,

- i analizon shkaqet dhe rrethanat që kanë çuar në shkelje të ligjeve,
- i përcakton personat përgjegjës për krijim të parregullsive të zbuluara dhe e përcakton përgjegjësinë direkte (të drejtpërdrejtë),
- parashtron kërkesa për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, përkatësisht penale dhe detyrime pronësore për kryerësit, kur ekzistojnë parakushte ligjore,
- kryen kontroll të zbatimit të masave të miratuara nga Kryeinspektori në lidhje me inspeksionin e kryer financiar dhe
- i analizon shkaqet dhe rrethanat që kanë çuar në prishjen e disiplinës financiare, përkatësisht moskryerjen, kryerjen e pandërgjegjshme dhe kryerjen jo në kohë të punëve gjatë menaxhimit me mjetet publike dhe i jep propozim Kryeinspektorit për marrjen e masave.

3. Bazat për fillimin e inspeksionit financiar

Neni 10

Inspeksioni financiar kryhet në bazë të:

- kërkesës, informatës ose fletëparaqitjes së mbështetur me dëshmi nga persona fizikë dhe juridikë,
- njoftimit ose evidencës për shkeljen e procedurave për menaxhim financiar dhe kontroll,
- raportit nga sfera e menaxhimit financiar dhe kontrollit,
- raportit të revizionit të brendshëm,
- raportit të Entit Shtetëror për Revizion,
- kërkesës nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
- kërkesës nga udhëheqësi ose i punësuari i subjektit nga sektori publik,
- kërkesës nga Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë dhe
- kërkesës nga Zyra Evropiane për Luftë kundër Mashtrimeve (OLAF - Office Europeen de Lutte Anti-Fraude).

4. Kriteret për përjashtim nga kryerja e inspeksionit financiar

Neni 11

(1) Inspektori financiar përjashtohet nga kryerja e inspeksionit financiar, nëse:

- në tri vitet e fundit ka punuar ose ka qenë anëtar i këshillit drejtues ose mbikëqyrës në subjektin në të cilin kryhet inspeksioni financiar,
- në tri vitet e fundit bashkëshorti ose farefisi i tij deri në shkallë të dytë është anëtar i këshillit drejtues ose mbikëqyrës në subjektin në të cilin kryhet inspeksioni financiar,
- ekzistojnë shkaqe racionale se ka interesa personale në aktivitetet që janë lëndë e kontrollit dhe
- ekzistojnë shkaqe tjera që japin dyshim për paanshmërinë e tij.

(2) Inspektori financiar menjëherë pas zbulimit se ekziston një nga shkaqet për përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, pa prolongim e ndërpret inspeksionin dhe menjëherë me shkrim e njofton Kryeinspektorin, i cili vendos për përjashtimin ose vazhdimin e kryerjes së inspeksionit financiar.

5. Statusi dhe rrogat

Neni 12

(1) Kryeinspektori dhe inspektorët financiarë kanë status të nëpunësve shtetërorë.

(2) Titujt e inspektorëve financiarë janë: inspektor i ri, inspektor, inspektor i lartë dhe ndihmëskryeinspektor.

(3) Inspektor i ri mund të jetë nëpunësi, i cili i plotëson kushtet për titullin bashkëpunëtor nga Ligji për nëpunës shtetërorë. Inspektori i ri mund të marrë pjesë në punën e ekipit të inspektorëve, por nuk mund në mënyrë të pavarur të realizojë inspeksion financiar.

(4) Inspektor mund të jetë nëpunësi, i cili i plotëson kushtet për titullin këshilltar nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(5) Inspektor i lartë mund të jetë nëpunësi, i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës i seksionit nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(6) Ndhimës kryeinspektor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin ndihmësudhëheqës i sektorit nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(7) Kryeinspektor mund të jetë nëpunësi, i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës i sektorit nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(8) Aktvendimet për përcaktimin e titujve nga paragrafi (2) i këtij neni i miraton ministri i Financave.

Neni 13

(1) Rroga e kryeinspektorit dhe inspektorëve financiarë përcaktohet në bazë të pikëve në vijim:

- kryeinspektor me 1.183 pikë,
- ndihmëskryeinspektor me 909 pikë,
- inspektori i lartë me 864 pikë,
- inspektor me 697 pikë dhe
- inspektor i ri 561 pikë.

(2) Vlera e pikëve nga paragrafi (1) i këtij neni është e barabartë me vlerën e pikës për rrogat e nëpunësve shtetërorë.

(3) Përvoja e punës dhe shkalla e karrierës së inspektorëve financiarë paguhet sipas Ligjit për nëpunës shtetërorë.

6. Të drejtat e inspektorit financiar

Neni 14

Gjatë kryerjes së inspeksionit financiar, inspektori financiar ka të drejtë:

- në qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe dokumentet relevante për inspeksionin, duke përfshirë dhe ato të klasifikuara me shkallë më të lartë, të cilat ruhen tek subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar,

- në qasje të pakufizuar në hapësirat dhe mjetet e subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar,

- të kryejë kontroll të ligjshmërisë së shpenzimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve (aktivi dhe pasivi), sistemeve të kontabilitetit dhe të të gjitha dokumenteve, duke përfshirë edhe ato në formë elektronike,

- të kërkojë nga subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar kopje të verifikuara nga dokumentet e lidhura me inspeksionin financiar në afatet e përcaktuara në kërkesën me shkrim nga neni 16 paragrafi (2) të këtij ligji,

- të kërkojë nga subjektet në të cilat kryhet inspeksioni financiar qasje në llogaritë bankare në vend dhe jashtë vendit në afate të përcaktuara,

- të kërkojë në afate të përcaktuara raporte të revizorëve të brendshëm, raporte nga Enti Shtetëror për Revizion dhe organet tjera kontrolluese, që ruhen tek subjekti në të cilat kryhet inspeksioni financiar,

- të kryejë kontroll dhe të kërkojë informata dhe kopje të verifikuara nga dokumentet edhe tek personat juridikë ose fizikë jashtë subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar në lidhje me kryerjen e inspeksionit financiar,

- të informohet nga gjykata kompetente për vendimet e miratuara në lidhje me masat e marra me aktivitetet inspektuese dhe

- të pengojë qasje të personave përgjegjës në kasaforta, magazina dhe sende të tjera që janë lëndë e inspeksionit financiar, me atë që do t'i vulosë në prezencë të personit zyrtar nga subjekti që është lëndë e inspeksionit.

7. Obligimet e inspektorit financiar

Neni 15

(1) Inspektori financiar vepron në mënyrë të ligjshme, në kohë dhe në pajtim me Kodeksin etik të nëpunësve shtetërorë dhe Kodeksin etik të shërbimit të inspeksionit.

(2) Gjatë kryerjes së inspeksionit financiar, inspektori financiar është i detyruar që ta njoftojë personin përgjegjës të subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar, për bazën ligjore për kryerjen e inspeksionit, fillimin e kryerjes së inspeksionit, vetëm nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe ose me njoftimin e tillë zvogëlohet efikasiteti i inspeksionit, ose për mbrojtjen e interesit publik dhe jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe pronës.

(3) Inspektori financiar e njofton personin përgjegjës të subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar në mënyrë objektive dhe të qartë për rezultatet nga inspeksioni i kryer, parregullsitë e përcaktuara dhe dëmet dhe shkaqet për krijimin e tyre si dhe për kundërvajtjet e përcaktuara në bazë të fakteve dhe rrethanave.

(4) Inspektori financiar e respekton besueshmërinë e të gjitha fakteve ose rrethanave që i ka konstatuar gjatë procesit të zbatimit të obligimeve të veta, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

(5) Inspektori financiar e ndërpret marrjen e cilavedo qoftë veprime me të cilat mund të pengohen veprimet hetuese.

8. Obligimet e subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar

Neni 16

(1) Subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar është i detyruar që inspektorit financiar:

- t'i mundësojë kryerje të papenguar të inspeksionit dhe t'i vë në qasje informatat dhe dokumentet që janë të nevojshme për kryerjen e inspeksionit,

- t'i sigurojë kushte të domosdoshme për punë të papenguar dhe për përcaktimin e gjendjes faktike dhe

- t'i mundësojë në afat të përcaktuar qasje në hapësirat, prodhimet, dokumentet ose cilido qoftë mjet tjetër që është lëndë e inspeksionit financiar.

(2) Subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar është i detyruar që me kërkesë me shkrim të inspektorit financiar, në afatin e përcaktuar me kërkesën e inspektorit, t'i dorëzojë ose përgatitë të dhëna të sakta dhe të plota, raporte, materiale ose dokumente tjera që janë të domosdoshme për zbatimin e inspeksionit financiar.

(3) Inspektori financiar mund të urdhërojë që subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar të kryej ndonjë aktivitet gjatë procedurës së inspeksionit për shkak të përcaktimit të tërësishëm të gjendjes faktike dhe të përcaktojë afat për kryerjen e atij aktiviteti.

(4) Subjekti në të cilin kryhet inspeksioni financiar nuk ka të drejtë që të refuzojë të japë informata nga inspeksionet e kryera paraprake financiare nga subjekte tjera që kryejnë kontroll, dokumente dhe të dhëna që ruhen në formë në letër ose elektronike me shkallë përkatëse të fshehtësisë, në pajtim me rregullat për mbrojtje të informatave të klasifikuara dhe dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale.

Neni 17

(1) Ministria e Financave nuk përgjigjet për dëmet ndaj personave të tretë që mund të krijohen për shkak të masave dhe aktiviteteve që i merr inspeksioni financiar në sektorin publik, përveç kur janë tejkualuar autorizimet e tij të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Për dëmet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk përgjigjen personat që janë ose kanë qenë inspektorë, vetëm në rast kur ata me aktgjykim të plotfuqishëm janë dënuar për vepër penale në lidhje me punën.

(3) Kryeinspektori dhe inspektorët financiarë, gjatë kohës dhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përkatësisht angazhimit në Ministrinë e Financave, nuk përgjigjen për dëmet ndaj personave të tretë që i kanë shkaktuar me kryerjen e detyrave të punës, nëse të njëjtat i kanë kryer në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me ligj.

III. PROCEDURA PËR KRYERJEN E INSPEKSIONIT FINANCIAR

1. Fillimi i procedurës për inspeksion financiar

Neni 18

(1) Procedurë për inspeksion financiar mund të ngritë Kryeinspektori në bazë të nenit 10 të këtij ligji dhe me urdhër të ministrit të Financave.

(2) Kryeinspektori para fillimit të inspeksionit financiar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji e njofton ministrin e Financave.

(3) Kryeinspektori vendos për fillimin e inspeksionit financiar, nëse merr informatë që sugjeron për dyshim të bazuar për menaxhim seriozisht të keq financiar.

2. Njoftimi për kryerjen e inspeksionit financiar

Neni 19

(1) Inspektori financiar përpilon raport për inspeksionin e kryer financiar me konstatime të mbështetura me dëshmi relevante dhe propozon masa që i dorëzon te Kryeinspektori.

(2) Pas miratimit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni nga Kryeinspektori, raporti dorëzohet te udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar që të japë vërejtje me shkrim në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të raportit.

(3) Në rast të parregullsisve të konstatuara, për dhënie të vërejtjeve me shkrim në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, kopje nga konstatimet në raportin dhe dëshmitë shoqëruese në mënyrë përkatëse u dorëzohen edhe personave në subjektin aktivitetet e të cilit kanë qenë lëndë e inspeksionit.

(4) Inspektori financiar që e ka kryer inspeksionin, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të vërejtjeve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, përpilon përgjigje me shkrim.

(5) Pas miratimit të përgjigjes, Kryeinspektori të njëjtën e dorëzon te udhëheqësi i subjektit në të cilin kryhet inspeksioni financiar, si dhe te personat nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Kryeinspektori, dokumentacionin e tërësishëm për inspeksionin e kryer financiar e dorëzon te ministri i Financave për informim të tij.

3. Masat që i ndërmerr Kryeinspektori

Neni 20

(1) Në bazë të raportit për inspeksion financiar në sektorin publik, Kryeinspektori mund t'i ndërmarrë masat në vijim:

- të kërkojë nga udhëheqësi i subjektit në të cilin kryhet inspeksion financiar që të ndërmarrë masa të domosdoshme për rishqyrtim të sistemeve për menaxhim financiar me qëllim që të mënjanohej parregullsitë dhe/ose të mënjanohej pasojat negative nga këto aktivitete,

- të kërkojë nga organi kompetent ose udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar që t'i ndërpret aktivitetet që kanë çuar në parregullsi ose shkaktuar dëm,

- të kërkojë nga organi kompetent ose udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar që t'i harmonizojë aktet interne me rregullativën për menaxhim financiar dhe kontroll,

- të kërkojë nga organi kompetent ose udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar që të ndërmarrë masa për dëmshpërblim material ose masa disiplinore në pajtim me ligj dhe të njoftojë për zbatimin e tyre në afat të caktuar dhe

- të bllokojë llogari bankare ose shfrytëzim të mjeteve të miratuara në buxhetin në nivel të programit, zërit ose projektit deri në mënjanimin e parregullsisve të konstatuara.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, udhëheqësi i subjektit në të cilin është kryer inspeksioni financiar, në afat prej 30 ditësh pas njoftimit të Kryeinspektorit, është i obliguar që në formë me shkrim ta njoftojë për masat dhe aktivitetet e ndërmarra.

4. Informimi i organeve

Neni 21

(1) Në rast të parregullsive të konstatuara gjatë kryerjes së inspeksionit financiar:

- te shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe fondet, informatat për parregullsitë duhet të dërgohen te ministri kompetent dhe/ose organi para të cilit është përgjegjës,

- në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetin e Shkupit dhe njësitë e tyre shfrytëzuese, informatat për parregullsitë dorëzohen edhe te kryetari i komunës dhe te Këshilli i komunës përkatësisht edhe te kryetari dhe te Këshilli i Qytetit të Shkupit,

- në agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personat tjerë juridikë të cilët janë në pronësi shtetërore ose në të cilat shteti është aksionar, si edhe tek organizatat joprofitabile dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë, informatat për parregullsitë dorëzohen edhe te Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht kryetari i komunës dhe Qyteti i Shkupit ose te personi juridik i cili ka pako menaxhuese në kapital dhe

- në shoqërinë tregtare në të cilën është ngritur procedurë e falimentimit ose likuidimit, informatat për parregullsitë dorëzohen te organi i cili ka të drejta pronësore të shtetit ose komunës dhe te organet e procedurës së falimentimit.

(2) Informatat për parregullsitë nga paragrafi (1) i këtij neni, Kryeinspektori i dorëzon edhe te ministri i Financave.

5. Raport vjetor

Neni 22

Ministria e financave parashtron në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë raport vjetor për punën e inspeksionit financiar në sektorin publik në vitin e kaluar, më së shumti deri më 31 mars në vitin e ardhshëm.

IV. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 23

Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 7 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje të kryer udhëheqësit të subjektit në të cilin kryhet inspeksioni, nëse:

- nuk mundëson kryerje të papenguar të inspeksionit dhe nuk i vë në qaje informatat dhe dokumentet të cilat janë të nevojshme për kryerjen e inspeksionit (neni 16 paragrafi (1) alineja 1);

- nuk ndërmerr masa për rishqyrtim të sistemeve për menaxhim financiar me qëllim që të mënjanohej parregullsitë dhe/ose të mënjanohej pasojat negative të këtyre aktiviteteve (neni 20 paragrafi (1) alineja 1);

- nuk i ndërpret aktivitetet të cilat kanë çuar në parregullsi ose kanë shkaktuar dëm (neni 20 paragrafi (1) alineja 2);

- nuk i harmonizon aktet interne me rregullativën për menaxhim financiar dhe kontroll (neni 20 paragrafi (1) alineja 3) dhe

- nuk ndërmerr masa për dëmshpërblim material ose masa disiplinore në pajtim me ligjin dhe nuk njofton për zbatimin e tyre në afat të përcaktuar (neni 20 paragrafi (1) alineja 4).

Neni 24

(1) Për kundërvajtjet nga neni 23 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje kumton gjykata kompetente.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj para parashtrimit të Kërkesës për ngritje të procedurës për kundërvajtje zbatohet procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji shfuqizohen dispozitat e nenit 51 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 90/2009 dhe 12/11).

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", e do të fillojë të zbatohet 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.